

INPO

Iniciativa për progres



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravede



E drejta për ujë, peng i prokurimit

**Analizë e tenderit maratonik për ujësjellës
në Komunën e Dragashit**

Prishtinë, korrik 2020

Autorët: Albulena Nrecaj dhe Mirvet Thaqi

Ekipi i Redaktorëve: Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Iniciativës për Progres – INPO dhe Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë” i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e INPO-së dhe IKD-së dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe Përkrahja Kombëtare për Demokraci (NED).

RRETH INPO

INPO, është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës avokohet për çështje shoqërore, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

INPO

Rr. Qamil Hoxha

Prishtinë

E: info@inpo-ks.org

www.inpo-ks.org

RRETH IKD

IKD është organizatë jo-qeveritare dhe jofitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Korrik 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Përmbajtja

I. Përmbledhje Ekzekutive	6
II. Metodologjia	8
III. Historiku i tenderit për ndërtimin e ujësjellësit në Dragash	9
IV. Maratona pesë vjeçare pa epilog e tenderit për ujesjellësin	11
a) Tenderi i parë - 2016.....	11
b) Tenderi i dytë – 2017	13
c) Saga e shqyrtimeve të prokurimit në OSHP	17
V. Gjetjet e veçanta në tenderin maratonik për ujësjellësin në Dragash	21
a) Shkeljet ligjore të Komunës së Dragashit në tenderin e ujësjellësit	21
b) Loja e “ping pongut” në mes të Komunës së Dragashit dhe OSHP-së	22
c) Dështimi i KRRP-së në monitorimin e tenderit dhe ndëshkimin e shkelësve	22
VI. Tenderi maratonik i ujësjellësit në organet e drejtësisë	23
VII. Rekomandime	26

I. Përmbledhje Ekzekutive

Furnizimi me ujë të pijshëm vazhdon të mbetet njëri ndër problemet kryesore me të cilin po ballafaqohen banorët 15 fshatrave të Komunës së Dragashit. Problemin me ujin e pijës nuk po mund ta zgjidhin për afro pesë vite me radhë për shkak të tenderit maratonik, i cili ka mbetur pa epilog, si rezultat i lojës së “ping pongut” me tender që po luhet në mes të Komunës së Dragashit dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit apo siç njihet Gjykatës së Tenderëve.

Tenderi i titulluar “Ujësjiellësi kryesor-Vazhdim i punimeve” i shpallur më 16 qershor 2017 (*projekt tre vjeçar ku parashihej vlera e tenderit rreth 2.021.824.00 euro*) vazhdon të mbetet peng i prokurimit, duke lënë pa ujë të pijes 15 fshatra të Komunës së Dragashit, përfshi fshatrat: Xërxë, Rrenc, Kapre, Bellobrad, Brrut, Zgatar, Kërstec, Rapçe, Pllavë, Brezne, Lubovisht, Kukalan, Mlik, Vraniq dhe Qyteza e Dragashit.

Qysh nga viti 2010, komuna e Dragashit ka nisur investimet për ndërtimin e sistemit të ujësjiellësit në territorin e komunës. Gjatë periudhës 2010–2014, komuna kishte investuar mbi 700,000.00 euro për këtë projekt.¹ Punimet ishin kryer nga operatorë ekonomikë (OE) të ndryshëm, të cilët kishin fituar kontratat, meqenëse komuna në mungesë të fondeve të mjaftueshme, realizimin e këtij projekti e kishte ndarë në faza, varësisht nga mjetet financiare në dispozicion.

Por, që nga viti 2016, komuna nuk ka mundur që të kontrakttoj asnjë OE për të vazhduar punimet e mbetura në gjysmë të projektit, nga i cili varet furnizimi me ujë të pijshëm i qytetarëve të 15 fshatrave të komunës së Dragashit.

INPO-IKD ka monitoruar dhe hulumtuar procesin e këtij tenderi maratonik dhe ka gjetur shkelje të ndërsjella të akterëve, të cilët realizimin e këtij tenderi jetik për fatin e furnizimit me ujë të pijës për 15 fshatrat e Dragashit e kanë shndërruar në lojë “ping pongu” ndërmjet Komunës së Dragashit - si Autoritet Kontraktues - dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), duke dëmtuar banorët e Dragashit dhe operatorët ekonomikë të përfshirë në këtë procedurë.

OSHP-ja, duke vendosur lidhur me ankesat e operatorëve ekonomikë, të cilët ishin të pakënaqur me njoftimet për dhënie të kontratës të iniciuar nga Komuna e Dragashit, e ka kthyer këtë lëndë nëntë (9) herë në **rivlerësim**, duke adresuar kritika ndaj autoritetit kontraktues për mos respektim të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe duke argumentuar se përzgjedhja e operatorit ekonomik ishte bërë në kundërshtim me kërkesat që i përmbante FDT, njoftimi për kontratë dhe dispozitave të LPP-së.

Në bazë të analizës së dokumenteve të tenderit dhe historikut të këtij tenderi INPO ka gjetur se Komuna e Dragashit ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, ku gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, ka rekomanduar për kontratë grupe të

¹ *Shënim:* Llogaritja është bërë përmes njoftimeve për dhënien e kontratave të prokurimit publik, për vitin 2010, 2011, 2012 dhe 2014.

OE-ve, të cilët pas rivlerësimeve i ka shpallur të eliminuar apo të papërgjegjshëm. Komuna nuk ka zbatuar nëntë (9) vendime dhe një (1) urdhëresë të OSHP-së si dhe nuk ka paguar gjobën e shqiptuar nga OSHP.

Komuna asnjëherë nuk ka rekomanduar për kontratë grupin e OE “Puna & Infra Plus” edhe pse është vërtetuar nga OSHP-ja se i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, dhe oferta e këtij OE është brenda kufinjëve të vlerës së parashikuar të kontratës. Komuna ka dështuar të zbatoj dispozitat e LPP-së, dhe të finalizoj projektin për furnizimin me ujë të pijës për qytetarët, duke dëmtuar në masë të madhe interesin publik dhe duke mos përmbushur obligimet e saj për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe efikase ndaj qytetarëve.

Tutje, INPO gjen se vendimet e OSHP-së dhe vendimet e komunës pas proceseve të rivlerësimit të tenderëve nuk kanë arritur t’i japin epilog të suksesshëm tenderit të ujësjellësit.

LPP obligon OSHP-në që gjatë shqyrtimeve të prokurimit të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundur, të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Në këtë kuptim, INPO gjen se OSHP nuk e ka luajtur rolin e saj gjatë shqyrtimit të prokurimit, duke lejuar që ky tender të shndërrohet në lojë “ping pongu” mes komunës dhe OSHP-së dhe që qytetarëve të Ju privohej e drejta e qasjes në ujë të pijës.

Tetë (8) vendimet e nxjerra dhe një (1) urdhëresë nga OSHP-ja, nuk kanë arritur që të zgjidhin “nyjen e prokurimit për ujë”. Rrjedhimisht, INPO vlerëson se OSHP qysh në seancën e tretë të shqyrtimit për shkak të përsëritjes së pikave ankimore dhe palëve të njëjta në procedurë, dhe për shkak të mosgatishmërisë së komunës për të zbatuar vendimet paraparake, është dashur që këtë çështje ta trajtojë si çështje të gjykuar më parë “*res judicata*” dhe të marrë vendim për anulimin e tenderit për t’i dhënë fund zvarritjes më shumë se katër (4) vite.

INPO gjen se KRPP nuk ka bërë ndonjë monitorim të këtij tenderi dhe nuk ka lëshuar asnjë rekomandim apo opinion. Sipas ligjit, KRPP është e obliguar që të bëjë monitorimin e aktiviteteve të prokurimit dhe ka përgjegjësinë e vëzhgimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore dhe rregullave të prokurimit.

INPO vlerëson se KRPP ka bërë shkelje të autorizimeve të saj ligjore dhe nuk ka kryer obligimet dhe detyrat e saj me profesionalizëm me rastin e refuzimit të marrjes së licencës për zyrtarin e prokurimit, siç ka vendosur OSHP. KRPP në këtë rast nuk ka vepruar pasi rasti është nën hetime. Kjo është ikje nga përgjegjësitë ligjore, sepse pezullimi i procedurës mund të ndodhë vetëm me vendim respektiv të gjykatës.

INPO gjen se “lufta” për tenderin maratonik të ujësjellësit në Komunën e Dragashit ka kaluar tashmë në organet e drejtësisë. Betejat për drejtësi po zhvillohen në dy fronte: 1) përmes kërkesës për hetime penale në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe 2) përmes padisë administrative në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

II. Metodologjia

INPO dhe IKD (*në vazhdim INPO*) me qëllim që të përpilojnë një raport sa më gjithëpërfshirës, analitik dhe të detajuar në lidhje me tenderin e shpallur nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Dragashit të titulluar “Ujësjellësi kryesor-Vazhdim i punimeve”, kanë përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij hulumtimi, INPO ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare përfshi: legjislacionin primar dhe sekondar, vendimet e AK, vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Ankesat e Operatorëve Ekonomikë (OE), Vendimet të tjera të institucioneve respektive, si dhe të dhëna të tjera të siguruara nga këto institucione përmes kërkesave për qasje në dokumente publike.

Mbi të gjitha, thelbi i draftimit të këtij raporti bazohet mbi monitorimin sistematik të rasteve të prokurimit, të cilën e bën INPO në fushën e prokurimit publik.

INPO pasi ka përmbledhur të gjitha të dhënat e terrenit, ka bërë analizë ligjore të trajtimit të këtij rasti nga organet përgjegjëse, të cilat kanë luajtur një lojë “ping pongu” mes vete, përfshi Komunën e Dragashit dhe OSHP-në. Kjo metodologji e hulumtimit ofron mundësi praktike që të bëhet identifikimi i problemeve dhe të analizohen të gjitha çështjet që janë me interes në shërbim të zbatimit të ligjit.

Pas identifikimit dhe analizimit të gjetjeve dhe çështjeve problematike karshi ligjit, standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, INPO ka zhvilluar intervista të thella me të gjithë hisedarët e përfshirë në këtë tender maratonik si dhe përfaqësuesit e institucioneve që zbatojnë ligjin. Intervistat janë zhvilluar në bazë të indikatorëve të vendosur si rezultati monitorimit të këtij tenderi, gjetjeve dhe vlerësimeve nga ana e analistëve juridikë të INPO-s dhe IKD-së.

III. Historiku i tenderit për ndërtimin e ujësjellësit në Dragash

Saga e këtij projekti kishte nisur në vitin 2016, kur komuna kishte iniciuar aktivitetin me titull “*Ndërtimi i ujësjellësit në Dragash-Vazhdim i punimeve*” nr.prokurimit: **621-2016-031-5-2-1**, me vlerë të parashikuar të kontratës **495,000.00 euro**. Për shkak të pakënaqësive të OE me rezultatet e prokurimit, ky tender ishte dërguar për shqyrtim në OSHP. Ankesat e OE ankues ishin aprovuar në tërësi dhe në lidhje me këtë shqyrtim të prokurimit, OSHP-ja kishte nxjerrë dy (2) vendime (*P.Sh.Nr.236/16 dhe P.Sh.334/16*), duke e obliguar komunën që lëndën ta kthejë në rivlerësim me udhëzimet që t’i përmbahet dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik gjatë procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Komuna kishte zbatuar vendimet e OSHP-së, duke e kthyer në rivlerësim tenderin vetëm në aspektin procedural, pasi që rezultatet e tenderit pas rivlerësimit të dytë përsëri ishin atakuar me ankesë në OSHP. Kjo e fundit pas ankesës së OE, kishte nxjerrë një urdhëresë (*P.Sh.426/16*) përmes së cilës kishte anuluar *njoftimin për dhënie të kontratës* dhe e kishte obliguar komunën që të zbatoj vendimet paraprake të OSHP-së.

INPO ka gjetur se komuna nuk ka zbatuar urdhëresën (*P.Sh.426/16*), dhe kundër kësaj OE kishte parashtruar ankesë në OSHP për shkak të moszbatimit të vendimeve dhe urdhërit të OSHP-së. Rreth kësaj ankese OSHP nxjerrë vendim (*P.Sh.50/17*) për gjykitje në vlerë prej 5,000.00euro për moszbatim të vendimeve paraprake të OSHP-së.

Komuna vendimin e parë të OSHP-së për rivlerësimin e tenderëve, e kishte zbatuar por jo edhe vendimin e dytë. Për këtë arsye OSHP-ja në bazë të ankesës së OE për moszbatimin e vendimit të OSHP-së, kishte nxjerrë urdhëresë me ç’rast e kishte urdhëruar komunën që të zbatojë vendimet paraprake dhe po ashtu për shkak të moszbatimit të vendimeve të OSHP-së brenda afatit ligjor, të njëjtën e kishtë gjykitur me 5,000.00€. Komuna asnjëherë nuk e ka përmbuar vendimin për gjykitje. Po ashtu, këtë aktivitet të prokurimit komuna e kishtë anuluar me arsyetimin se nuk ka mjete financiare në dispozicion, pasi që ministria e financave i kishte tërhequr fondet e pashpenzuara për këtë projekt.

Saga e këtij projekti ka vazhduar në 2017, kur më 16 qershor të këtij viti, Komuna e Dragashit kishte bërë publikimin e *njoftimit për kontratë* për aktivitetin e prokurimit me numër **621-17-2649-5-1-1**, ku parashihej vazhdimi i punimeve për ndërtimit të ujësjellësit me një vlerë të parashikuar të kontratës **2.021.824.00 euro**.

Qëllimi dhe përmbajtja e këtij tenderi ishin identike me ato të tenderit me numër **621-2016-031-5-2-1** të vitit 2016, vetëm se kësaj radhe ky tender ishte i vlerës së madhe, meqenëse komuna kishte rritur disa paramasa dhe pozicione.

Ky tender që nga vitit 2017 deri më tash është shndërruar në lojë “ping pongu” mes komunës dhe OSHP-së. Rezultatet e këtij tenderi janë përshkruar me 9 ankesa në OSHP, respektivisht me 8 vendime për anulim të njoftimit për dhënie të kontratës dhe kthim në rivlerësim të tenderit dhe një (1) urdhëresë. Në të gjitha vendimet e nxjerra

nga OSHP-ja, ishte konstatuar se komuna gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve kishte bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, duke rekomanduar për kontratë OE-të, të cilët nuk i kishin plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, respektivisht kërkesën - *Kontrata të realizuara jo më pak se (3,032,736.00 euro) të lëmisë së këkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare: (2014,2015,2016).*

Gjatë sagës së rivlerësimeve të tenderit, komuna dy (2) herë kishte rekomanduar për kontratë grupin e OE “EBK & Gashi Ing & VODOSKOK & Muratori”², pesë (5) herë grupin e OE “Fanaj Inxhiniering & Lala”³ dhe dy (2) herë “ALFA-ING & AL-TRADE”⁴. Ndërkaq, grupi i OE, i cili është ankuar në vazhdimësi rreth rezultateve të tenderit, “Puna & Infra Plus” asnjëherë nuk ishte rekomanduar për kontratë, edhe pse në vendimet e OSHP-së⁵ ishte konstatuar se ky OE i plotëson të gjitha kriteret e dosjes.

Rrjedhimisht, INPO vlerëson se komuna ka bërë shkelje të vazhdushme të nenit 59 të LPP-së, duke mos vlerësuar dhe ekzaminuar me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm tenderët, pasi që OE të rekomanduar për kontratë gjatë sagës së rivlerësimeve në disa raste janë shpallur të sukseshëm, në disa të tjera janë eliminuar. Vlen të theksohet se sipas letrës standarde të datës 14.01.2019 grupi i OE “Puna & Infra Plus” është shpallur i passukseshëm, për arsye se vlera e ofertës së këtij grupi të OE-ve, nuk ishte çmimi më i ulët. Çka nënkupton se ky i fundit i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka qenë i përgjegjshëm, mirëpo nuk e ka plotësuar kriterin kryesor të çmimit më të ulët.

² Njoftimi për dhënie të kontratës i datës: 22.10.2017 dhe 11.06.2018

³ Njoftimi për dhënie të kontratës, i datës: 11.12.2017, 26.02.2018, 17.09.2018, 28.06.2019 dhe njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës: 23.01.2020.

⁴ Njoftimi për dhënie të kontratës i datës: 12.11.2018 dhe 25.01.2019.

⁵ PSh.59/20

IV. Maratona pesë vjeçare pa epilog e tenderit për ujesjellësin

INPO ka analizuar në detaje maratonën e tenderit të ujesjellësit për fshatrat e Dragashit dhe në vazhdim sjellë kronologjinë e këtij tenderi, gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet.

a) Tenderi i parë - 2016

Titulli: Ndërtimi i ujësjetës në Dragash-Vazhdim i punimeve

Nr.prokurimit: 621-2016-031-5-2-1,

Vlera e parashikuar: 495,000.00euro,

Më 2 qershor 2016, Komuna e Dragashit kishte iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull *“Ndërtimi i ujësjetës në Dragash-Vazhdim i punimeve”* nr.prokurimit: **621-2016-031-5-2-1**, me vlerë të parashikuar **495,000.00 euro**, Kontratë pune, vlerë e mesme, procedurë e hapur.⁶

Kriter kryesor për dhënien e kontratës ishte tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Ndër të tjera, për të dëshmuar kapacitetin teknik dhe profesional, komuna kishte kërkuar që OE të interesuar të ofrojnë listën e kontratave të realizuara në shumën jo më pak se 742 500.00 euro të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2013, 2014 dhe 2015) dhe si dëshmi të ofrohen referencat/procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve të lëshuara nga punëdhënsit e tyre. Ndërkaq, për të dëshmuar kapacitetin ekonomik dhe financiar, komuna kishte kërkuar që OE duhet të ofrojë dëshmi për qarkullim financiar, gjatë tre viteve të fundit (2013, 2014 dhe 2015) jo më pak se 990,000.00 euro.

Fitues i kësaj kontrate më vlerë prej 340,752.34euro, ishte shpallur N.P.T “FANAJ INXHINJERING” me seli në Prizren.⁷

Kundër këtij njoftimi grupi i OE “PUNA” & K-ING”, brenda afatit ligjor ishte ankuar në OSHP. Pretendimet e OE ankues ishin se OE fitues, nuk i kishte plotësuar kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional dhe se komuna nuk i kishte vlerësuar tenderët sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Këtë pretendim të OE ankues, e kishte aprovuar edhe OSHP, në përbërje të panelit nga Nuhi Paqarizi – kryetar, Blerim Dina – anëtar dhe Tefik Sylejmani – referues, ku

⁶ Komuna e Dragashit: Njoftim për kontrtë, nr.aktiviteteit të prokurimit 621-2016-031-5-2-1, publikuar më 02.06.2016, në uebfaqen e Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik.

⁷ Komuna e Dragashit: Njoftim për Dhënien e Kontratës nr.aktiviteteit të prokurimit: 621-2016-031-5-2-1, publikuar më 09.08.2016, në uebfaqen e Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik.

ishite konstatuar se OE "FANAJ INXHINJERING" nuk i kishte përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit, siç kishte pretenduar komuna dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim.⁸

Pas rivlerësimit, komuna ka shpallur fitues grupin e OE "EBK" dhe "GASHI ING" me vlerë të kontratës prej 369,149.75euro.⁹

Grupi i OE "PUNA & K-ING", përsëri kishin parashtruar ankesë në OSHP, duke kundërshtuar arsyen e eliminimit të cilën komuna i'a kishte theksuar përmes letrës standarde për operatorin e eliminuar. Letrën standarde për OE të eliminuar INPO nuk e ka pasur në dispozicion për ta analizuar, por sipas përmbajtjes së vendimit të OSHP-së, [PSh.nr.334/16](#), thuhet se komuna në bazë të një vendimi¹⁰ të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit të kësaj komune, i ka refuzuar kërkesën OE "Puna" për lëshimin e referencës për punët e kryera dhe se e njëjta është e papërgjegjshme. Arsyetimin e vendimit komuna e kishte bazuar në pretendimin se menaxheri së bashku me OE nuk i kanë përfunduar të gjitha punimet sipas kontratës "Ndërtimi i ujësjellësit kryesor në Dragash - vazhdimi i punimeve" nr. i prokurimit: 621-14-63-5-2-1, në vitin 2014.

Në bazë të kësaj, INPO vëren se gjatë përgatitjes për të ofertuar në tenderin në fjalë, OE "PUNA", kishte kërkuar lëshimin e një reference nga Drejtoria e Urbanizimit në Dragash, për kontratën me titull "Ndërtimi i ujësjellësit kryesor në Dragash - vazhdimi i punimeve" nr. i aktivitetit të prokurimit: 621-14-63-5-2-1, të cilën e kishte implementuar gjatë vitit 2014.¹¹

Tutje sipas përmbajtjes së vendimit të [PSh.334/16](#), përfaqësuesi i AK-së në seancë të shqyrtimit të prokurimit, kishte deklaruar se OE "PUNA" për shkak të mos realizimit të punëve i ka shkaktuar dëm komunës në vlerë rreth 50,000.00 euro. Mirëpo, këtë pretendim komuna nuk e kishte të konstatuar nga ndonjë gjykatë kompetente në vend, pasi që asnjëherë nuk kishte parashtruar padi në gjykatë për të vërtetuar pretendimet e saj.

Për më tepër, INPO ka gjetur se komisioni për pranimin teknik të punimeve për kontratën "Ndërtimi i ujësjellësit kryesor në Dragash - vazhdimi i punimeve" me nr. të prokurimit 621-14-63-5-2-1, kishte konkluduar se OE "Puna" Sh.P.K nuk kishte përfunduar në tërësi punët sipas paramasës dhe parallogarisë. Sipas procesverbalit të komisionit të pranimit teknik të punimeve vetëm 96.43% e punimeve sipas kontratës ishin përfunduar.¹² Komisioni kishte deklaruar se nuk ka asnjë lloj kundërshtimi për cilësinë e punimeve dhe punët e kryera deri në vlerën 209,733.14 euro të pranohen.

⁸ Vendimi PSh.nr.263/16, i qasshëm në: http://arkivaoshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2016/263-16-vend-kk-dragash_1.PDF

⁹ Komuna e Dragashit: Njoftim për Dhënien e Kontratës –Rivlerësim, nr.aktiviteteit të prokurimit: 621-2016-031-5-2-1, publikuar më 30.09.2016, në uebfaqen e Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik.

¹⁰ Vendimi nr. 06-400-9631, i datës 20.06.2016, Drejtoria e Urbanizimit, Komuna e Dragashit.

¹¹ Komuna e Dragashit: Njoftim për Dhënien e Kontratës nr.aktiviteteit të prokurimit: : 621-14-63-5-2-1, publikuar më 19.09.2016, në uebfaqen e Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik.

¹² Procesverbal i pranimit teknik të projektit, i datës 24.12.2014, hartuar nga komisioni për pranimin teknik të punëve sipas vendimit të Kryetarit të Komunës 02.Nr.400-22518/14, i datës 18.12.2014, Komuna Dragash.

Komuna për punët e pakryera sipas kontratës, nuk i kishte konfiskuar sigurinë e ekzekutimit të kontratës OE.

Rrjedhimisht, komuna në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë (LPP), e kishte eliminuar OE ankues, pasi që të gjitha kërkesat dhe kriteret tjera të kërkuara në dosjen e tenderit i kishte plotësuar dhe arsyetimi për eliminimin e tij ishte i paqëndrueshëm sipas ligjit.

Tutje, OSHP kishte marrë vendim që AK të bëjë anulimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe pas rivlerësimit lëndën ta kthejë në rivlerësim.¹³

Pas rivlerësimit të dytë, më 22 nëntor 2016, komuna kishte publikuar njoftimin për dhënien e kontratës¹⁴, dhe përsëri kishte shpallur fitues OE "FANAJ INXHINJERING", edhe pse OSHP përmes vendimeve [Psh.nr.263/16](#) dhe [Psh.nr.334/16](#) kishte konstatuar se ky OE nuk i kishte plotësuar kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional dhe se komuna kishte vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

OE "Puna" ShPK, përsëri ankohet në OSHP, e cila nxjerrë *Urdhëresë*,¹⁵ përmes së cilës anulon vendimin për dhënie të kontratës dhe urdhëron komunën që të zbatojë vendimet paraprake të OSHP-së, vendimin [PSh.nr.263/16](#) dhe [PSh.nr.334/16](#).

Pavarësisht vendimeve dhe urdhëresës së OSHP-së, Komuna e Dragashit nuk e kishte kthyer në rivlerësim tenderin, dhe pas ankesës së OE "PUNA" Sh.P.K kundër komunës për mos zbatimin e Urdhëresës [PSh.nr.423/16](#) për zbatimin e vendimeve [PSh.nr.263/16](#) dhe [PSh.nr.334/16](#), OSHP nxjerrë vendim përmes së cilit i shqipton gjobë komunës së Dragashit në vlerë prej 5,000.00 euro.¹⁶

Komuna e Dragashit nuk e ka paguar gjobën.

b) Tenderi i dytë – 2017

Titulli: Ndërtimi i ujësjellësit në Dragash-Vazhdim i punimeve (Projekt tre vjeçar)

Nr.prokurimit: 621-17-2649-5-1-1,

Vlera e parashikuar: 2,021,824.00euro,

¹³ Vendimi PSh.334/16, i qasshëm në: http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2016/334-16vendim_1.PDF

¹⁴ Njoftimi për dhënie të kontratës, i qasshëm në: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=VieëNotices&ID=132092>

¹⁵ Urdhëresë PSh.nr.423/16, e qasshme në: http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/423-16urdh_1.PDF

¹⁶ Vendimi PSh.nr.50/17, i qasshëm në: http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/50-17-vendim_1.PDF

Më 16 qershor të vitit 2017, Komuna e Dragashit kishte bërë publikimin e njoftimit për kontratë me titull **“Ujësjiellësi kryesor-Vazhdim i punimeve (Projekt tre vjeçar)”** nr.prokurimit **621-17-2649-5-1-1**, ku parashihej realizimi i këtij projekti me një vlerë rreth **2,021,824.00 euro**.¹⁷

Ky tender ishte i njëjtë me tenderin e vitit 2016 të anuluar nga ana e komunës për shkak të mungesës së mjeteve financiare, vetëm se kësaj radhe ishte publikuar si tender me vlerë të madhe.

Ndër kushtet për pjesëmarrje në tenderim, komuna kishte kërkuar nga OE të interesuar që të ofrojnë dëshmi të kënaqëshme se qarkullimi vjetor gjatë tri (3) viteve të fundit (2016, 2015, 2014) ka qenë në vlerë jo më pak se 4,043,648.00 euro, në mënyrë që të dëshmohet kapaciteti ekonomik dhe financiar, ndërkaq për të dëshmuar kapacitetin teknik dhe profesional, komuna kishte kërkuar kontrata të realizuara në shumën jo më pak se 3,032,736.00 euro.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	Dëshmia e kërkuar dokumentare
Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor gjatë tri (3) viteve të fundit (2014, 2015, 2016) ka qenë në vlerë së bashku në tri vitet e fundit jo më pak se 4,043,648.00 euro.	Pasqyrat financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri (3) vitet e fundit (2014,2015,2016), apo deklarata tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri (3) vitet e fundit (2014,2015,2016).
Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare
Kontrata të realizuara jo më pak se (3,032,736.00 euro) të lëmisë së këkuar në periudhën e shkuar tri (3) vjeçare: (2014,2015,2016).	Listën e kontratave, bashkangjitur referencat ose procesverbalet e pranimit përfundimtare të punëve me sukses të realizuara, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve në lëmin e kërkuar, ne tri (3) vitet fundit (2014, 2015 dhe 2016).

Tabela 1. Kapacitet ekonomikë financiar dhe dëshmitë e kërkuara dokumentare.

Sipas vlerësimit të INPO-s kërkesat për kapacitetin ekonomik dhe financiar ishin jo profesionale pavarësisht se ishin brenda kërkesave ligjore. Neni 68, i LPP-së sqaron se autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga OE që të parashtrijnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal

¹⁷ Komuna e Dragashit: Njoftim për kontrtë, nr. të prokurimit 621-17-2649-5-1-1, publikuar më 16.06.2017, në uebfaqen e Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik.

vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë, ky qarkullim nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do t'i referohen maksimum tri (3) viteve të fundit financiare.

Mirëpo vlera e qarkullimit financiar të kërkuar në dosjen e tenderit prej 4,043,648.00 euro, sipas vlerësimit të INPO-s nuk është kërkesë minimale, siç udhëzon ligji. Për më tepër, kjo kërkesë që nga fillimi është dashur të konsiderohet nga komuna, duke pasur parasysh rrezikun potencial që nuk do të ketë mjaftueshëm oferta dhe nuk do t'i stimulon ndërmarrjet e mesme për të ofertuar. Për më tepër, komuna nuk e ka rumbullakësuar vlerën e kërkuar të qarkullimit financiar psh. në 4,000,000.00 euro. Kjo, pasi që, sipas një logjike të thjeshtë, OE i cili qarkullimin e tij financiar në vitet e kërkuara do ta kishte vetëm për 1 euro më të ulët se sa vlera e kërkuar me dosje të tenderit atëherë ky OE do të ishte e papërgjegjshëm. Në këtë drejtim, INPO vlerëson se vendosja e kësaj kërkesë ka rezultuar të jetë jo profesionale, duke pasur parasysh edhe faktin se 6 nga 7 OE kanë kërkuar bashkëpunimin e OE të tjerë, në mënyrë që të plotësojnë shumën totale të kërkuar. Në anën tjetër, pikë kontestuese e rezultateve të tenderit, gjatë maratonës së shqyrtimeve në OSHP ka rezultuar të jetë pikërisht përmbushja e kësaj vlere nga OE ofertues.

Praktikë e njëjtë është përdorur edhe në vendosjen e kërkesave sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional, ku vlera e përbashkët e kontratave nga lëmi i kërkuar në tri (3) vitet e fundit duhet të jetë jo më pak se 3,032,736.00 euro. Komuna nuk kishte saktësuar mënyrën se në bazë të cilave dëshmi dokumentare do të vlerësohej përmbushja e këtij kriteri. Po ashtu, kjo kërkesë ka rezultuar të jetë pikë kontestuese e rezultateve të tenderit, pasi gjatë shqyrtimeve në OSHP, asnjëherë nuk ishte vërtetuar se OE të rekomanduar për kontratë kishin arritur të dëshmojnë së e plotësojnë këtë kriter.

Tutje, gjatë afatit tenderues, Grupi i OE "Puna" Sh.P.K. kishte parashtruar ankesë në OSHP kundër njoftimit për kontratë, duke pretenduar se komuna kishte bërë shkelje duke mos i zbatuar vendimet dhe urdhëresën e OSHP-së ([PSh.263/16](#), [PSh.334/16](#) dhe [PSh.423/16](#)) lidhur me tenderin paraprak të vitit 2016, ku në të gjitha këto vendime OSHP kishte urdhëruar komunën që tenderin ta kthejë në rivlerësim.

Arsyetimet e komunës për moszbatim të vendimeve ishin për arsye se për shkak të stërzgjatjes së procedurave ankimore, i është bërë shkurtim i buxhetit të paraparë për financimin e projektit, pasi kjo kontratë ishte planifikuar të financohej nga granti qeveritar dhe se qeveria i kishte tërhequr mjetet e pashpenzuara ashtu siç parashihet me ligj.

OSHP, e kishte vlerësuar si pjesërisht të bazuar ankesën e OE "Puna" Sh.P.K dhe kishte vendosur që të mbetet në fuqi njoftimi për kontratë i datës 16.06.2017. Vlen të theksohet se OE "Puna" Sh.P.K nuk ishte ankuar rreth kritereve të vendosura në dokumentet e tenderit.

Tutje, pavarësisht kërkesave të dosjes, për këtë tender komuna kishte pranuar shtatë (7) oferta. Gjashtë (6) prej tyre ishin dorëzuar nga grupe të OE dhe vetëm një (1) OE kishte ofertuar i vetëm.

	EMRI I TENDERUESIT	ÇMIMI OFERTËS euro
1	Fanaj Inxhinjering & LALA	1,151,532.41
2	ALFA.i	1,585,175.14
3	Puna & Infra-Plus	1,581,495.11
4	Eleganca-Com & Adriatik	1,847,781.84
5	Renelual Tahiri & Xërxa	1,779,557.85
6	EBK & VODOSKOK & Gashi Ing & Muratori	1,087,848.66
7	ALFA-ING & AL-TRADE	1,282,701.55

Tablela 2. Operatorët ekonomik që kanë dorëzuar tenderë.

Komuna e Dragashit pas vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, në tetor 2017, fitues e kishte shpalluar grupin e OE “EBK” & “Gashi ING” & “VODOSKOK” & “MURATORI”.¹⁸

¹⁸Njoftim për dhënie të kontratës, i qashshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=84412

c) Saga e shqyrtimeve të prokurimit në OSHP

Në nëntor të vitit 2017, pas ankesave të grupit të OE: “Fanaj Inxhinjering & “LALA”, dhe grupi OE “Puna” & “Infra-Plus” kundër njoftimit për dhënie të kontratës, OSHP kishte anuluar vendimin për dhënie të kontratës (**Vendimi PSH.nr. 392/17, 400/17**) pasi ishte konstatuar se OE fitues nuk e kishte përmbushur kërkesën për ofrimin e licencës për gurëthyes në pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr si dhe nuk ka përmbushur kërkesat për kapacitet ekonomik dhe financiar. Tenderi ishte kthyer në rivlerësim.

Pas **rivlerësimit të parë** komuna kishte rekomanduar për Kontratë Grupin OE “Fanaj Inxhinjering & LALA”,¹⁹ dhe përsëri ky vendim ishte anuluar nga OSHP-ja më 26 janar 2018 (**Vendimi PSH.nr.507/17**) pasi ishte konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë nuk i kishte përmbushur kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim.

Pas **rivlerësimit të dytë** komuna kishte rekomanduar për kontratë sërish grupin e OE “N.P.T Fanaj Inxhinjering & LALA Sh.p.k”²⁰, por edhe ky vendim ishte anuluar nga paneli shqyrtues i OSHP-së më 19 prill 2018 (**Vendimi PSH.nr. 77/18**) dhe lënda është kthyer në rivlerësim.

Rezultatet e **rivlerësimit të tretë**, kishin rekomanduar për kontratë grupin e OE “EBK & Gashi Ing & Vodoskoka & Muratori”-Prizren, por ky vendim përsëri ishte anuluar nga OSHP-ja më 24 korrik 2018 dhe ishte kthyer në rivlerësim (**Vendimi PSH.nr.256/18, 261/18**), pasi që ishte konstatuar si çështje e gjykuar më parë (*res judicata*) me dy vendime paraprake të OSHP-së, ku ishte konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional, respektivisht, kontratat e realizuara në shumën jo më pak se 3,032,736.00 euro në periudhën e shkuar tre (3) vjeçare të lëmisë dhe dëshmitë se posedon licencë për gurëthyes në pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavor.

Grupi i OE “NTP Fanaj Inxhinjering” & LALA” SHPK, përsëri ishin rekomanduar për kontratë pas **rivlerësimit për të katërtën herë** nga ana e komunës, por pas ankesave, OSHP-ja kishte nxjerrë Urdhëresë duke urdhëruar Komunën që të zbatonte vendimin P.Sh256/18 (**Urdhëresa PSH.nr.486/18, 504/18**).

Pas **rivlerësimit të pestë**, Komuna e Dragashit kishte rekomanduar për kontratë grupin e operatorëve ekonomik “NPN “ALFA-ING” & “AL-TRADE” SHPK, por ky

¹⁹ Njoftim për dhënie të kontratës, i qashshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=9602

²⁰ Njoftim për dhënie të kontratës, e qashshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=113596

vendim ishte anuluar nga OSHP-ja më 3 janar 2019 dhe ishte kthyer lënda në rivlerësim. **(Vendimi PSH.nr.641/18).**

Komuna kishte zbatuar vendimet e OSHP-së kishte **rivlerësuar për herë të gjashtë** tenderët dhe kishte rekomanduar për kontratë përsëri grupin OE “NPN “ALFA-ING” & “AL-TRADE” SHPK, por njoftimi për dhënie përsëri ishte anuluar nga OSHP-ja më 18 mars 2019 dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim **(Vendimi PSH.nr.42/19)**. Kësaj radhe OSHP kishte angazhuar ekspertin teknik që t’ia bëjë një super ekspertizë lëndës dhe ishte konstatuar se grupi OE i rekomanduar për kontratë nuk posedon kontrata dhe referenca për punë sipas vlerës së kërkuar në dosje e tenderit.

Komuna pas **rivlerësimit për herë të shtatë** kishte rekomanduar përsëri OE “Fanaj Inxhiniering & Lala SHPK”-Prizren, por edhe ky njoftim për dhënie të kontratës ishte anuluar nga OSHP-ja me 7 tetor 2019 dhe përsëri ishte kthyer në rivlerësim.**(Vendimi PSH.nr.371/19),**

Pas rivlerësimit të tetë deri më tani, komuna sërisht kishte rekomanduar për kontratë Grupin e OE N.P.T “Fanaj Inxhiniering & Lala SHPK” për aktivitetin e prokurimit të cekur si më lartë, por edhe ky njoftim për dhënie të kontratës ishte anuluar nga OSHP-ja me vendimin e nxjerrë më 11 mars 2020 **(Vendimi PSH.nr.59/20)**. Sipas këtij vendimi, komuna përsëri ka shpërblyer me kontratë grupin e OE që ishte shpallur i papërgjegjshëm sipas vendimeve paraprake të OSHP-së dhe se zyrtari i prokurimit kishte vepruar në kundërshtim me ligjin, duke mos e kërkuar vazhdimin e validitetit të sigurimit të tenderit brenda afateve ligjore. Tutje, OSHP përmes vendimit **PSh.59/20**, ka kërkuar anulimin e liçencës së prokurimit për zyrtarin e prokurimit të komunës së Dragashit, me arsyen se i njëjti nuk ka kërkuar vazhdimin e validitetit të sigurisë së tenderëve para skadimit të tyre.

Pas vendimit **PSh.59/20** për anulimin e dhënies së kontratës dhe kthimit në rivlerësim të tenderit, Komuna ka publikuar në e-prokurim një njoftim ku deklaron se “AK- Dragash në bazë të vendimit të OSHP-së **Psh.59/20** kjo lëndë do të dërgohet brenda afateve ligjore në Gjykatën Themelore në Prishtinë në Departamentin për Çështje Administrative kundër vendimit të OSHP-së.”

OE i rekomanduar	OE Ankues	Neni	Rekomandimi i ekspertit	Vendimi i OSHP
EBK & Gashi Ing & VODOSKOK&Muratori	Fana Inxhiniering & Lala dhe Puna & Infra Plus	56, 59	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim PSh.392-400/17
Fanaj Inxhiniering & Lala	Puna & Infra Plus	59.4, 72	Refuzohet ankesa	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim PSh.507/17
Fanaj Inxhiniering & Lala	Puna & Infra Plus	59.2, 72	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim 77/18
EBK & Gashi Ing & VODOSKOK & Muratori	Fana Inxhiniering & Lala dhe Puna & Infra Plus	59,72	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim PSh.256 - 261/18
Fanaj Inxhiniering & Lala	EBK & Gashi Ing & VODOSKOK & Muratori dhe Puna & Infra Plus	4.1.26	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet pjesërisht ankesa / Urdhëresë PSh.486 - 504/18 U
ALFA-ING&AL-TRADE	Puna & Infra Plus	59,60	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim PSh.641/18
ALFA-ING & AL-TRADE	Puna & Infra Plus	59.4,69	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim PSh.42/19
Fanaj Inxhiniering & Lala	Puna & Infra Plus	59,60, 72,29 dhe 31 RRU OPP,	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim PSh.371/19
Fanaj Inxhiniering & Lala	Puna & Infra Plus	59, 60, 69	Aprovohet pjesërisht ankesa / Ri-vlerësim	Aprovohet ankesa / Ri-vlerësim P.Sh59/20

Tabela 3. OE ankues dhe vendimet e OSHP-së.

OSHP-ja përmes vendimeve të lartcekura kishte shpallur si operatorë ekonomik të papërgjegjshëm:

1. Grupin e OE: "EBK & Gashi ING & VODOSKOK D.D & MURATORI" i cili ishte shpallur i papërgjegjshëm me dy vendime të OSHP-së: **PSH.nr.392/17, 400/17** të dt. 23 nëntor 2017 dhe **PSH.nr.256/18, 261/18** të dt. 24 korrik 2018.
2. Grupin e OE: "Fanaj Inxhiniering & Lala", i cili OE është shpallë i papërgjegjshëm me pesë vendime të OSHP-së: **PSH.nr.507/17** të dt.26 janar 2018; **PSH.nr.77/18** të dt.19 prill 2018; **Urdhëresa e OSHP-së PSH.nr.486/18, 504/18** e dt 17 tetor 2018; **PSH.nr.371/19** të dt. 7 tetor 2019 dhe **PSH.nr. 59/20** të dt.11 mars 2020.
3. Grupin e OE: "ALFA-ING" & AL-TRADE", ishte shpallë i papërgjegjshëm me tri vendime të OSHP-së: PSH.nr.507/17 të dt. 26 janar 2018; PSH.nr.641/18 të dt. 3 janar 2019 dhe Vendimin PSH.nr. 42/19 të dt. 18 mars 2019.

Ndërsa, OSHP-ja me vendimin **PSH.nr.59/20** të nxjerrë më 11 mars 2020, ka shpallur si të përgjegjshëm OE: "Puna SHPK & N.N "Infra-Plus", dhe se në lidhje me këtë pretendim paneli shqyrtues kishte konstatuar se ky operator ekonomik e plotësonte kërkesën sipas FDT, Njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Në bazë të analizës së shqyrtimeve në OSHP dhe vendimeve të nxjerra, INPO vlerëson se OSHP pavarësisht se ka vepruar brenda kompetencave ligjore për të shqyrtuar çdo pretendim ankimor të OE-ve, megjithatë në asnjë mënyrë nuk është dashur të lejohet që shqyrtimi për këtë tender të shëndërrohet në sagë pa epilog, duke pasqyruar edhe papërgjegjshmërinë e komunës për zbatuar vendimet e OSHP-së (**PSH.nr. 392/17, 400/17 dhe PSH.nr.507/17**) me ç'rast është udhëzuar që vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ta bëjë sipas ligjit dhe kriterëve të dosjes së tenderit. Rrjedhimisht, OSHP është dashur që qysh në mars të vitit 2018 për shkak të përsëritjes së pretendimeve ankimore të OE "Puna & Infra Plus" këtë çështje ta trajtoj si "*res judicata*" sipas obligimeve të nenin 105 të LPP-së dhe të marr vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe të urdhëroj komunën se në rast se ka interes të vazhdojë këtë tender të bëjë ritenderimin e tij duke u kujdesur që gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit të zbatohet obligimet ligjore me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

Po ashtu, INPO sjell në vëmendje nenin 104 i LPP, sipas të cilit OSHP është e obliguar që gjatë shqyrtimeve të prokurimit të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundur, të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Për shkak të zgjatjes së shqyrtimit të prokurimit për gati pesë (5) vite me radhë, interesi publik është dëmtuar në masë të madhe, duke u privuar nga e drejta e qasjes në ujë të pijes qytetarët e 15 fshatrave të komunës së Dragashit në njërin anë, dhe anën tjetër mjetet financiare të destinuara për këtë projekt janë shkurtuar, me ç'rast edhe

për shkak të mungesës së mjeteve financiare komuna nuk do të mund të vazhdojë lidhjen e kësaj kontrate.²¹

V. Gjetjet e veçanta në tenderin maratonik për ujësjellësin në Dragash

Në bazë të hulumtimit të këtij rasti, INPO në vazhdim në mënyrë të përmbledhur liston gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet konkrete.

a) Shkeljet ligjore të Komunës së Dragashit në tenderin e ujësjellësit

- Në bazë të analizës së dokumenteve të tenderit dhe historikut të këtij tenderi INPO ka gjetur se komuna ka bërë shkelje të nenit 69 të LPP-së ku gjatë hartimit të dosjes së tenderit nuk ka vepruar në mënyrë profesionale gjatë vendosjes së kërkesave sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional, ku ka kërkuar që vlera e përbashkët e kontratave nga lëmi i kërkuar në tri (3) vitet e fundit të jetë jo më pak se 3,032,736.00 euro. Komuna është dashur që të rrumbullakësoj këtë vlerë p.sh. në 3,000,000.00 euro, pasi që apriori një OE i cili për 1 euro nuk përmbush këtë vlerë do të shpallej i papërgjeshëm. Tutje, komuna nuk ka saktësuar mënyrën se në bazë të cilave dëshmi dokumentare do të vlerësohej përmbushja e këtij kriteri *(a do të vlerësohej dhe kalkuloj vetëm paramasa dhe çmimi i pozicioneve për ujësjellës apo totali i kontratave të ofruara në tërësi)*. Po ashtu, kjo kërkesë ka rezultuar të jetë pikë kontestuese e rezultateve të tenderit, pasi gjatë shqyrtimeve në OSHP, asnjëherë nuk ishte vërtetuar se OE të rekomanduar për kontratë kishin arritur të dëshmojnë se e plotësojnë këtë kriter.
- Komuna ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, ku gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, ka rekomanduar për kontratë grupe të OE-ve, të cilët pas rivlerësimeve i ka shpallur të eliminuar apo të papërgjegjshëm.
- Komuna nuk ka zbatuar nëntë (9) vendime dhe një (1) urdhëresë të OSHP-së si dhe nuk ka paguar gjobën e shqiptuar nga OSHP.
- Komuna asnjëherë nuk ka rekomanduar për kontratë grupin e OE “Puna & Infra Plus” edhe pse është vërtetuar nga OSHP-ja se i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, dhe oferta e këtij OE është brenda kufinjëve të vlerës së parashikuar të kontratës.
- Komuna ka dështuar të zbatoj dispozitat e LPP-së, dhe të finalizoj projektin për furnizimin me ujë të pijës për qytetetarët, duke dëmtuar në masë të madhe

²¹ **Shënim:** Sipas LIGJI NR. 07/L-001 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2020, për projektin e ujësjellësit në Dragash, total për vitin 2020-2022 janë të ndara vetëm 452,000.00 euro, apo më pak se gjysma e vlerës së parashikuar të kontratës.

interesin publik dhe duke mos përmbushur obligimet e saj për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe efikase ndaj qytetarëve.

b) Loja e “ping pongut” në mes të Komunës së Dragashit dhe OSHP-së

Vendimet e OSHP-së dhe vendimet e komunës pas proceseve të rivlerësimit të tenderëve nuk kanë arritur t'i japin epilog të suksesshëm tenderit të ujësjes.

LPP obligon OSHP-në që gjatë shqyrtimeve të prokurimit të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Në këtë kuptim, INPO gjen se OSHP nuk e ka luajtur rolin e saj gjatë shqyrtimit të prokurimit, duke lejuar që ky tender të shndërohet në lojë “ping pongu” mes komunës dhe OSHP-së dhe që qytetarëve të Ju privohej e drejta e qasjes në ujë të pijes.

Tetë (8) vendimet e nxjerra dhe një (1) urdhëresë nga OSHP-ja, nuk kanë arritur që të zgjidhin “nyjen e prokurimit për ujë”. Rrjedhimisht, INPO vlerëson se OSHP qysh në seancën e tretë të shqyrtimit për shkak të përsëritjes së pikave ankimore dhe palëve të njëjta në procedurë, dhe për shkak të mosgatishmërisë së komunës për të zbatuar vendimet paraparake, duke mos vlerësuar sipas ligjit tenderët, është dashur që këtë çështje ta trajtojë si çështje të gjykuar më parë “*res judicata*” dhe të marrë vendim për anulimin e tenderit.

Veprimet kësajsoj do të evitonin zvarritjen e zgjidhjes së prokurimit për katër (4) vite me radhë dhe do të obligonte komunën që të zbatoj dispozitat e LPP-së duke mundësuar apriori që ritenderimi të kishte epilog të suksesshëm.

c) Dështimi i KRRP-së në monitorimin e tenderit dhe ndëshkimin e shkelësve

Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) nuk ka bërë ndonjë monitorim të këtij tenderi dhe nuk ka lëshuar asnjë rekomandim apo opinion.²² Sipas LPP, KRPP është e obliguar që të bëjë monitorimin e aktiviteteve të prokurimit dhe ka përgjegjësinë e vëzhgimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore dhe rregullave të prokurimit.²³

INPO vlerëson se për shkak të zvarritjeve të këtij tenderi dhe interesit të lartë publik, KRPP është dashur që me automatizëm të angazhohet në monitorimin dhe vlerësimin e këtij tenderi sipas aspektit të përputhshmërisë me dispozitat e LPP-së dhe rregullat e prokurimit.

Tutje, OSHP në bazë paragrafit 9 të nenit 25 të LPP-së, më 11.11.2019 kishte parashtuar kërkesë në KRPP për anulimin e certifikatës së prokurimit për zyrtarin

²² Përgjigje e KRPP-së përmes postës elektronike, me 25.06.2020.

²³ Ligji Nr.04-L/042 për Prokurimin Publik, neni 87 dhe 88.

përgjegjës të prokurimit të komunës së Dragashit, me arsyetimin se i njëjti nuk kishte zbatuar pesë (5) vendime të OSHP-së.²⁴

Ndërkaq, KRPP refuzon që ta trajtojë çështjen e parashtruar nga OSHP, respektivisht t'ia anuloj certifikatën e prokurimit zyrtarit të komunës, me arsyetimin se bordi i KRPP është në dijeni se Njësia e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren është duke e hetuar rrjedhën e aktivitetit të prokurimit në fjalë, dhe në këtë mënyrë nuk dëshirojnë që të interferojnë në punën e institucioneve të drejtësisë.²⁵

INPO vlerëson se me këtë vendim KRPP ka bërë shkelje të autorizimeve të saj ligjore dhe nuk ka kryer obligimet dhe detyrat e saj me profesionalizëm. Thënë më shkurtë kjo vlerësohet si ikje nga përgjegjësitë ligjore, sepse në cilindo rast të kësaj natyre, assesi nuk pezullohet procedura pa një vendim respektiv të organeve të drejtësisë, të cilat vendime mund të merren në pajtim me ligjin, duke caktuar masë të përkohshme, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast.

Sipas paragrafit 8 të nenit 25 të LPP-së, KRPP është e mandatuara që zyrtarëve që kanë bërë shkelje të rëndë të LPP-së dhe rregullave të prokurimit t'ua anulojë certifikatën. Po ashtu, sipas paragrafit 9 të nenit 25 të LPP-së, KRPP bazuar në kërkesën e ndonjë Autoriteti Kontraktues ose OSHP, duhet të vendosë nëse janë plotësuar kushtet apo janë bërë shkelje të rënda të LPP-së dhe në këtë mënyrë duhet të konstatojë nëse zyrtarit duhet t'i anulohet certifikata apo jo.

Rrjedhimisht, sipas vendimit nr.07/2020, i datës: 03.02.2020, bordi i KRPP-së ka dështuar që të zbatoj obligimet ligjore për trajtimin e kërkesës për anulimin e certifikatës së prokurimit zyrtarit të komunës dhe se ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

VI. Tenderi maratonik i ujësjellësit në organet e drejtësisë

“Lufta” për tenderin maratonik të ujësjellësit në Komunën e Dragashit ka kaluar tashmë në organet e drejtësisë. Betejat për drejtësi po zhvillohen në dy fronte: 1) përmes kërkesës për hetime penale në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe 2) përmes padisë administrative në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Për betejën e parë ka disa kallëzime penale të inicuar në drejtim të zyrtarëve të Komunës së Dragashit, të cilat ende janë në shqyrtim nga Prokuroria Themelore në Prizren.

Operatori ekonomik “Puna SHPK” kishte parashtruar dy kallëzime penale lidhur me dyshimet për keqpërdorim me rastin e zbatimit të procedurave tenderuese nga

²⁴ Kërkesa nr.1249/19 e OSHP-së.

²⁵ Vendimi i Bordit të KRPP-së nr.07/2020 i datës: 03.02.2020.

Autoriteti Kontraktues- KK Dragash, tender ky i titulluar: *“Ujësjetllësi kryesor-Vazhdim i punimeve (projekt tre vjeçar).”*

Fillimisht, ky operator ekonomik më 22 janar 2019 kishte dorëzuar kallëzimin penal me nr. të dokumentit: 00052721 në Prokurorinë Themelore në Prizren, kundër të pandehurve N.N persona nga Drejtoria e Prokurimit të Komunës Dragash dhe N.N persona nga Komuna Dragash, për shkak të dyshimit për kryerjen e veprave penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 të KPRK-së, dhe veprës penale “Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike”, në kundërshtim me nenin 284 të KPRK-së.

Në këtë kallëzim penal, ky operator ekonomik kishte bashkangjitur një sërë provash ku arsyetonte se “Komuna e Dragashit nuk ka zbatuar urdhëresën dhe 5 Vendime të plotfuqishme si dhe ligjet në fuqi për Aktivitetin e Prokurimit me numër 621-17-2649-5-1-1 në lidhje me “Ujësjetllësi kryesor-Vazhdim i punimeve (Projekt tre vjeçar)”. Kjo rekomandon për kontratë Grupe të Operatorëve Ekonomikë që janë shpallur të papërgjegjshëm me vendime të plotfuqishme të OSHP-së, duke shkelur seriozisht të drejtat e palës së dëmtuar PUNA SHPK në njërën anë, si dhe duke i cenuar statusin e operatorit ekonomik të barabartë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në tenderin me të dhënat si më sipër”, thuhet në kallëzimin penal të dorëzuar në janar të vitit 2019 në PTh në Prizren.

Për të njëjtat pretendime, OE “Puna SHPK”, më 23 prill 2020 kishte paraqitur kallëzim penal edhe në drejtim të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kundër: 1. Nuro Ismailit, menaxher i prokurimit në Komunën e Dragashit, 2. Fadil Sinanit, zyrtar i lartë i zyrës së prokurimit dhe 3. Shenasi Qafleshit, po ashtu zyrtar i lartë i zyrës së prokurimit, për shkak të dyshimit se këta persona duke vepruar bashkërisht apo ndaras kanë kryer veprat penale si në vijim: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar” nga neni 414 të Kodit nr. 06/l-074 Penal të Republikës së Kosovës, veprës penale “Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik” nga neni 415 të KPRK-së, dhe veprës penale “Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike”, nga neni 278 të KPRK-së.

Ky operator ekonomik ka arsyetuar se “personat Zyrtar nga Zyra e Prokurimit të KK së Dragashit, me qëllim që për vete ose për personin tjetër të përfitojnë dobi pasurore dhe me qëllim që palës së dëmtuar ti shkaktojnë dëm, kanë keqpërdorur autoritetin zyrtar duke i tejkaluar kompetencat e tyre, fillimisht duke favorizuar operatorë ekonomikë të papërgjegjshëm, duke i rekomanduar për kontratë e më pastaj duke refuzuar të zbatojnë vendimet e plotfuqishme të Organit Shqyrtues të Prokurimit si organ administrativ i shkallës së tyre, vendimet e të cilit janë të plotfuqishme. Zyrtarët e prokurimit në mënyrë kundërligjore dhe në kundërshtim me Vendimet e OSHP-së, tentojnë të bëjnë eliminimin kundërligjor të ofertës së kompanisë “PUNA SHPK” dhe në anën tjetër synojnë të shpërblejnë me kontratë kompanitë që nuk i plotësojnë kushtet e Tenderit” thuhet në kallëzimin e dorëzuar nga OE “Puna SHPK” në PSRK.

Ky operator ekonomik, në kallëzimin e dorëzuar në PSRK kishte përmendur faktin se më parë i ishte drejtuar PTH në Prizren, dhe sipas saj, duke ofruar fakte të bollshme, por që gjendja kishte mbetur e njëjtë, andaj edhe i ish-in drejtuar PSRK-së, në mënyrë që ajo me urgjencë ta hetoj këto shkelje sistematike, të dokumentuara nga ky operator, thuhet tutje në këtë kallëzim penal.

Mirëpo, një rast i tillë, siç dokumentohet nga shkresat e lëndës, më 7 maj 2020 ishte deleguar në kompetencë në PTh në Prizren nga PSRK-ja.

Prokuroria Themelore në Prizren ka ngarkuar prokurorin Metush Biraj²⁶ që ta trajtojë këtë lëndë të prokurimit. Në përgjigjen zyrtare për IKD-INPO, prokurori Biraj, ka thënë se në lidhje me këtë lëndë të prokurimit janë paraqitur disa kallëzime penale dhe plotësime të këtyre kallëzimeve penale, me pretendimin se janë kryer vepra penale nga zyrtarët e Komunës së Dragashit. “Prokuroria Themelore në Prizren për herë të parë më 29.01.2019, ka autorizuar Njësitin për Hetimin e Krimeve Ekonomike (NJHKEK), në Prizren, për të mbledhur të dhëna, prova dhe informacione shtesë në drejtim të verifikimit të pretendimeve nga kallëzuesi penal”, thuhet në përgjigjen e prokurorit Biraj. Tutje, sipas prokurorit kallëzuesit kanë bërë denoncime në lidhje me rastin e njëjtë në datat 18.04.2019, 21.06.2019 dhe 14.10.2019.

NJHKEK, në Prizren, sipas prokurorit, gjatë kësaj periudhe kohore duke vepruar sipas Autorizimeve të kësaj Prokurorie ka kryer një varg veprimesh hetuese ndaj Zyrtarëve të Komunës së Dragashit, mirëpo në ndërkohë është bërë një riorganizim i gjithmbarshëm i Policisë së Kosovës e në këtë kuadër edhe i këtij Njësi, për çka objektivisht është pamundësuar vazhdimi i shpejtë dhe i koordinuar në grumbullimin e provave dhe informatave tjera në drejtim të kompletimit të këtij rasti penal.

“Më 08.05.2020, në këtë Prokurori, përmes Prokurorisë Speciale na është dorëzuar në kompetencë lëndore kallëzimi i denoncuesit Vahidin Halili, ku kryesisht cekën pretendimet e njëjta se menaxheri i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Dragashit Nuro Ismaili dhe Zyrtarët e Lartë të Prokurimit të kësaj Zyre Fadil Sinani dhe Shenasi Qaflehi, me veprimet apo mosveprimet e tyre si persona zyrtar duke mos i respektuar qëllimisht rreth 9 Vendime të PSH të OSHP, kanë kryer veprat penale të përcaktuar me Ligj”, thekson prokurori Biraj.

Gjatë muajit Qershor 2020, prokurori Biraj thekson se përmes bisedave që i ka pasur me Udhëheqësin e këtij Njësi dhe Hetuesin e ri të ngarkuar me këtë rast penal, janë dakorduar që sa më shpejtë të merren në pyetje edhe Anëtarët e Komisionit Vlerësues për tenderin në fjalë, të grumbullohen edhe provat tjera. “Jemi në pritje që sa më shpejtë të na dërgohet kallëzimi penal në mënyrë që ne pastaj sa më **Urgjentisht** të vazhdojmë me procedim edhe formal penal gjegjësisht që eventualisht nëse ka dyshim të arsyeshëm se të dyshuarit e mundshëm mund të jenë implikuar në veprat

²⁶ Intervistë e IKD-INPO përmes postës elektronike me Prokurorin e Prokurorisë Themelore në Prizren, z. Metush Biraj. 28 qershor 2020.

penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare, të marrim Aktvendim për fillim të hetimeve”, thuhet në përgjigjen e prokurorit Biraj.

Për betejën e dytë, sipas zyrtarëve të prokurimit në Komunën e Dragashit, ka një padi administrative të inicuar në Departamentin Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Sipas menaxherit të prokurimit në Komunën e Dragashit, Nuro Ismaili²⁷, padia është dorëzuar më 10 prill 2020 në gjykatën respektive dhe janë ende në pritje të shqyrtimit të kësaj lënde. Menaxheri Ismaili thotë se OShP vazhdimisht e ka kthyer këtë tender në rivlerësim në mënyrë të kundërligjshme, dhe se për këtë kanë vlerësime nga mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë në Kosovë që merren me fushën e prokurimit. Për këtë arsye, sipas menaxherit Ismaili, lënda është dërguar në gjykatë sepse vetëm OShP është duke dhënë vlerësim ndryshe nga të gjithë të tjerët në lidhje me këtë tender, vlerësime këto të cilat, sipas tij, janë të kundërligjshme. Përndryshe, menaxheri Ismaili, thekson se vërejtjet dhe rekomandimet e OShP-së për Komunën e Dragashit gjithmonë kanë qenë që të eliminohen tre operatorët konkurrues dhe që të shpërblehet operatori ekonomik ankues, i cili kishte qenë me çmim 400,000.00 euro më i shtrenjtë se tre operatorët e tjerë. Këto rekomandime, zyrtarët e Komunës së Dragashit i konsiderojnë të kundërligjshme dhe të dëmshme për Komunën e Dragashit.

Se si do të rrjedhin gjërat në organet e drejtësisë në trajtimin e këtyre lëndëve, INPO dhe IKD do të monitorojnë të gjitha zhvillimet për të mbajtur të informuar publikun për këtë këto lëndë prej të cilave mbahet peng e drejta elementare e realizimit të projektit që mundëson furnizimin me ujë të pijshëm për 15 fshatrat e Komunës së Dragashit.

VII. Rekomandime

INPO në vazhdim ofron rekomandime konkrete me qëllim që të sigurohet integritet në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit publik në mënyrë që të finalizohet qëllimi i prokurimit dhe të evitohen proceset e gjata të shqyrtimit të prokurimeve, gjithnjë duke pas parasysh zbatimin efikas të ligjit dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët nga të gjitha palët e përfshira në prokurim dhe autoritetet tjera mbikëqyrëse dhe rregullatore, përfshi edhe organet e drejtësisë.

Për komunën e Dragashit:

- Kryetari i komunës duhet të mbajë përgjegjës brenda kompetencave dhe autorizimeve të tij ligjore, të gjithë zyrtarët komunal të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe vlerësimin dhe ekzaminimin e tyre.

²⁷ Intervistë e IKD-INPO përmes postës elektronike me Menaxherin e Prokurimit në Komunën e Dragashit, z. Nuro Ismaili. 17 qershor 2020.

- Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se zyra e prokurimit zbaton në plotëni dispozitat e LPP-së gjatë zhvillimit aktiviteteve të prokurimit, me fokus të veçantë vlerësimin dhe karahasimin e tenderëve.
- Zyra e Prokurimit të zbatoj vendimet e OSHP-së në aspektin përmbajtësor, duke i'u përmbjatur udhëzimeve përmbajtësore të tyre.

Për Organin Shqyrtues të Prokurimit:

- OSHP të luajë rol proaktiv në zgjidhjen e sukseshshme të shqyrtimeve të prokurimit dhe të mos lejoj zgjatjen me vite të proceseve të shqyrtimit.
- OSHP-në që gjatë shqyrtimeve të prokurimit të veprojnë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.
- Në rast të përsëritjes së pikave ankimore dhe palëve, OSHP të anuloj aktivitetet e prokurimit me qëllim të evitimit të procesve të gjata ankimore dhe trajtimit të dinjitetshëm të OE-ve të përfshirë në prokurim.

Për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik:

- KRPP të rrisë numrin e monitorimeve të aktiviteteve të prokurimit dhe të zbatoj obligimet e saj ligjore për mbikëqyrjen e prokurimit.
- KRPP të trajtojë me seriozitet dhe profesionalizëm kërkesat e OSHP-së për anulimin e certifikateve të zyrtarëve të prokurimit, duke mos ikur nga përgjegjësia e saj ligjore për trajtimin dhe vendosjen kundrejt kësaj natyre të kërkesave.

Për sistemin gjyqësor dhe prokurorial:

- Departamenti për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në përputhje me obligimet ligjore, duhet ta trajtojë me prioritet këtë lëndë për shkak të rëndësisë së veçantë që ka për interesin publik.
- Prokuroria Themelore në Prizren në përputhje me obligimet ligjore duhet ta trajtojë këtë lëndë me prioritet për shkak të rëndësisë së veçantë që ka për interesin publik.